



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1770/3 Prot.

Tiranë, më 17.07.2025

VENDIM

Nr. 38 Datë 17.07 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE JASHTË ORARIT ZYRTAR TË PUNËS
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", neni 90, pika 1, pika 2, neni 91, pika 3, të VKM Nr. 568, datë 6.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes Kreu II. "Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë" pikat 7, 10, 13, mbështetetur në Urdhërin e Rektorit nr. 142 datë 27.06.2025 "Për angazhimin jashtë orarit zyrtar të punës, për stafin e ngarkuar me procesin e akreditimit të programit të studimit "Doktoratë" në "Aktivitet Fizik dhe Shëndeti" si dhe të programit të studimit të Ciklit të tretë "Doktoratë" në Shkenca Sportive, si dhe në shkresën e Rektorit nr. 1637/2 datë 14.07.2025 "Përcjellje e tabelave për realizimin e orëve jashtë orarit për stafin e angazhuar me procesin e akreditimit të programit të studimit "Doktoratë" në FSHL dhe FVFR", në Relacionin nr 1758 datë 14.07.2025 "Mbi miratimin e pagesës së orëve jashtë orarit zyrtar të punës, Bordi I Administrimit në mbledhjen e datës 17.07.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesës së orëve jashtë orarit zyrtar të punës, për stafin e angazhuar në kuadrin e procesit të akreditimit të programit të studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë" në FSHL dhe FVFR, tabela bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI